

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË LIGËS UNIKE

Në bazë të nenit 19 të Statutit të Ligës Unike (në tekstin e mëtejme Liga), Bordi Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2020_miratoi këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË LIGËS UNIKE

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

1. Bordi Drejtues është organi më i lartë ekzekutiv i Ligës UNIKE.
2. Anëtarët e Bordit Drejtues i zgjedhin Federatat themeluese të Ligës UNIKE (Federata Shqiptare e Basketbollit dhe Federata e Basketbollit të Kosovës) në pajtim me Statutin e saj.
3. Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi apo dorëheqja e anëtarëve të Bordit Drejtues bëhen në pajtim me Statutin e Ligës dhe aktet tjera normative të Ligës.
4. Për punën dhe funksionimin e vet, Bordi Drejtues i përgjigjet Federatave themeluese të Ligës.

Neni 2

Përgjegjësitë e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues obligohet që t'i kryejë të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga Statuti dhe aktet tjera normative të Ligës.
2. Në pajtim me Statutin e Ligës, Bordi Drejtues ushtron përgjegjësitë në vijim:
 - a. Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera normative të Ligës.
 - b. Bën pranimin e klubeve si anëtare të Ligës UNIKE.
 - c. Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme në konsultim me Federatat themeluese të Ligës.
 - d. Nxjerr Rregulloren për Punën e Bordit Drejtues dhe rregullore tjera të brendshme që janë me rëndësi për zhvillimin e aktivitetit të Ligës.
 - e. Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të Ligës Unike.
 - f. Emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv të Ligës Unike.
 - g. Emëron dhe shkarkon Komesarin e Garave të Ligës Unike.
 - h. Formon trupa punuese të veta dhe emëron dhe shkarkon anëtarët e tyre.

-
- i. Përcakton strukturën organizative të Ligës, duke miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Ligës Unike.
 - j. Disponon me pasurinë e Ligës Unike.
 - k. Miraton listën e zyrtarëve të autorizuar nga dy Federatat themeluese të Ligës për ndeshjet e zhvilluara nën ombrellën e Ligës Unike (gjyqtarë, vëzhgues, kontrollorë) dhe cakton lartësinë e taksës për zyrtarët e ndeshjeve.
 - l. Bartë të drejtën e organizimit të garave nën kompetencë të Federatave themeluese.
 - m. Miraton Rregulloren e Garave, kalendarin e garave dhe cakton lartësinë e kootizimit për klubet dhe lartësinë e pagesave për shërbimet të cilat i kryen Liga Unike për klubet.
 - n. Miraton Sistemin e Garave.
 - o. Miraton Rregulloren e Marketingut.
 - p. Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në Ligë Unike, dhe lartësinë e pagave të tyre.
3. Bordi Drejtues mund të kryejë edhe funksione tjera të cilat i delegohen nga Federatat themeluese të Ligës Unike, si dhe të gjitha funksionet të cilat shprehimisht me Statut apo me aktet tjera normative të Ligës apo me legjislacionin në fuqi nuk i delegohen Federatave themeluese të Ligës apo ndonjë organi tjetër kompetent.

Neni 3

Delegimi i kompetencave të Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues mund të krijojë këshilla dhe komisione ad hoc, në rast se të njëjtat konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e tij. Në rast të tillë, Bordi Drejtues do t'ua përcaktojë atyre detyrat, kohëgjatësinë, kompetencat dhe fushëveprimtarinë funksionale.
Puna në trupa të tilla punuese do të zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Bordi Drejtues mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre edhe një personi të vetëm.
3. Bordi Drejtues mund t'i autorizojë punonjësit administrativ apo profesional të Ligës Unike që të kryejnë ndonjë punë që është nën kompetencën e Bordit Drejtues.

Neni 4

Sekretari i Bordit Drejtues

1. Drejtori Ekzekutiv i Ligës Unike shërben edhe si Sekretar i Bordit Drejtues dhe merr pjesë në të gjitha takimet e tij.
2. Sekretari i Bordit Drejtues është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e Bordit Drejtues, për mbarëvajtjen e korrespondencës me shkrim mes Bordit Drejtues dhe anëtarëve dhe komisioneve të veta, dhe për dërgimin e ftesave dhe rendit të ditës tek anëtarët e Bordit Drejtues.
3. Sekretari i Bordit Drejtues është përgjegjës për formulimin e vendimeve të miratuara në Bordin Drejtues dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së Bordit Drejtues.
4. Sekretari i Bordit Drejtues është përgjegjës për mbajtjen e arkivit të Bordit Drejtues.

Neni 5

Punimet e Bordit Drejtues

1. Anëtarët e Bordit Drejtues për mbledhjet e Bordit njoftohen përmes ftesave fizike dhe/ose elektronike, të cilat dërgohen së paku tre ditë para mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.
3. Rendi i ditës për mbledhjet e Bordit Drejtues dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit Drejtues, duhet t'i dërgohen të gjithë anëtarëve të të njëjtit së bashku me ftesën për mbledhjen e radhës.
4. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese. Kjo kërkesë duhet t'i parashtrohet me shkrim Kryetarit apo Sekretarit të Bordit Drejtues (Drejtorit Ekzekutiv), në formë fizike apo elektronike.
5. Mbledhjet e Bordit Drejtues kryeson Kryetari i tij. Në mungesë të tij, me autorizim paraprak me shkrim, mbledhjet e Bordit mund t'i kryesojë ndonjë anëtar i Bordit Drejtues në koordinim me Drejtorin Ekzekutiv të Ligës.
6. Në mbledhjet e Bordit Drejtues, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtarë ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Bordit Drejtues.
7. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes së paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia merr fjalën anëtarit.

8. Për të gjitha mbledhjet e Bordit Drejtues mbahet procesverbali nga Sekretari i Bordit Drejtues, apo në mungesë të tij nga ndonjëri prej anëtarëve të Bordit Drejtues. Procesverbali duhet t'i përmbajë të gjitha vendimet e nxjerra nga Bordi Drejtues si dhe të gjitha diskutimet relevante në favor apo kundër vendimeve përkatëse.
9. Procesverbali i mbledhjeve të Bordit Drejtues mbahet në formë të plotë arkivat e Bordit Drejtues, ndërsa ekstrakti i të njëjtit i dërgohet të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
10. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit Drejtues bëhet në mbledhjen e parë vijuese të tij, si pikë e parë e rendit të ditës.

Neni 6

Vendimet e Bordit Drejtues

1. Vendimet e Bordit Drejtues mund të merren me shumicë votash në njërën nga dy mënyrat në vijim:
 - a) Në mbledhje të Bordit Drejtues, në të cilën të pranishëm janë së paku shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues. Vendimet e Bordit Drejtues do të jenë të vlefshme në rast se për to votojnë shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues të pranishëm në mbledhjen në fjalë.
 - b) Përmes deklaramit elektronik të anëtarëve të Bordit Drejtues, me ç'rast vendimet janë të vlefshme vetëm në rast se për miratimin e tyre deklarohen shumica e të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues. Materialet përcjellëse dhe forma e projektvendimit që mëtohet të nxirret përmes formës së përcaktuar në këtë nënparagraf duhet të dërgohen së paku një ditë para afatit të përcaktuar për deklaram elektronik.
2. Propozimet për nxjerrjen e vendimeve sipas formës së përcaktuar në nënparagrafin b) të paragrafit 1 të këtij neni i bën Kryetari i Bordit Drejtues, ndërsa i administron Sekretari i Bordit Drejtues (Drejtori Ekzekutiv).

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e Punës së Bordit Drejtues të Ligës Unike hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimin nga Kryetari.

Miratuar më 24.09.2020

Në emër të Bordit Drejtues,

Ilir TREBICKA

Kryetar

Liga UNIKE